



PSH.nr.864/20

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, në përbërje të Nuhi Paçarizi - Kryetar, Blerim Dina - Referues, Goran Milenković - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik “G&A Consulting” SH.P.K - Prishtinë, kundër njoftimit për anulim të aktivitetit të prokurimit me titull “Ndërtimi i objektit të QMF-së në Fshatin Prelez”, me nr. të prokurimit: 656-20-4400-5-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) - KK-Ferizaj, më datë: 23.11.2020, mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHET, si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik “G&A Consulting” SH.P.K - Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Ndërtimi i objektit të QMF-së në Fshatin Prelez”, me nr. të prokurimit: 656-20-4400-5-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) –KK-Ferizaj.

II. ANULOHET, njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit me titull: “Ndërtimi i objektit të QMF-së në Fshatin Prelez”, me nr. të prokurimit: 656-20-4400-5-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) –KK-Ferizaj dhe lënda kthehet në **Rivlerësim**.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues “G&A Consulting” SH.P.K - Prishtinë, aprovohet si e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

ARSYETIM

Operatori ekonomik ankues “G&A Consulting” SH.P.K - Prishtinë, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me dt: 08.10.2020 me nr.864/20, kundër njoftimit për anulim të aktivitetit të prokurimit me titull: “Ndërtimi i objektit të QMF-së në Fshatin Prelez” , me nr. të prokurimit: 656-20-4400-5-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) –KK-Ferizaj, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenet: 1, 6, 7, 42, 52, 54, 59, 62, 72 dhe 108/A të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 30.10.2020, ka autorizuar ekspertin shqyrtues të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti shqyrtues i prokurimit në raportin e dt: 10.11.2020, lidhur me pretendimin ankimore të OE-ankues sqaron si në vijim:

Ekspertit shqyrtues në lidhje me pretendimin ankimor nr.1 të parashtruar nga OE ankues “G&A CONSULTING” SH P. K duke u bazuar në fakte të prezantuar në dokumentacionin që kam pranuar në shqyrtim: Njoftim për anulimin e aktivitetit të prokurimit, për të cilin OE ankues ka pretendime për arsyen e anulimit të këtij aktiviteti si dhe Planit Zhvillimor Komunal 2017-2025 i Komunës së Ferizajt për periudhën 8 vjeçare të miratuar sipas Vendimit 01 Nr. 147 dt.: 25.09.2017, sqaroj se AK-ja Komuna e Ferizajt – Njësia kërkuese në bazë të Planit Zhvillimor Komunal i cili ka qenë në fuqi me rastin e inicimit të këtij aktiviteti të prokurimit, ka qenë i obliguar që këtë objekt sipas: Nenit 21 të PZHK ta pajisë me kushte ndërtimore – “Kushtet ndërtimore janë kushtet të cilat shërbejnë si bazë për hartimin e dokumentacionit ndërtimor për çdo parcelë kadastrale ...”

Nëse AK-ja, përkatësisht Njësia kërkuese - Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale kishte bërë kërkesën për marrjen e Kushteve Ndërtimore para fillimit të aktivitetit të prokurimit e që në bazë të PZHU-së është e detyrueshme, Drejtoria e Urbanizmit për dhënien e Kushteve Ndërtimore e kishte njoftuar Njësinë Kërkuese se parcela në fjalë është përfshirë në Planin Zhvillimor Komunal 2017-2025, dhe është destinuar për Afarizëm Tregti-Industri dhe nuk mund të pajiset me Kushte Ndërtimore për destinimin e kërkuar. Njësia

Kërkuese pas marrjes së kësaj përgjigjeje për parcelën, nuk kishte bërë kërkesë për fillimin e aktivitetit të prokurimit. Mirëpo njësia kërkuese nuk ka vepruar në bazë të PZHU-së dhe ka bërë kërkesën për fillim të aktivitetit të prokurimit, në bazë të së cilës është bërë Njoftimi për Kontratë, si dhe është bërë hapja e ofertave. Ofertat i kanë dorëzuar katër Operatorë Ekonomik të cilët kanë bërë shpenzime për përgatitjen e tyre, dhe AK-ja është e obliguar që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit, përkatësisht me vlerësimin, krahasimin dhe ekzaminimin e ofertave .

Prandaj bazuar në dëshmitë e lartpërmendura rezulton se ky pretendim i OE ankues është i bazuar.

Lidhur me pretendimin e OE "G&A CONSULTING" SH P. K se AK-ja nuk na ka ofruar qasje në dokumente edhe përkundrazi kërkesës që kemi dorëzuar tek AK më datës: 09.10.2020, ekspertit shqyrtues duke u bazuar në fakte të prezantuar në dokumentacionin që kam pranuar në shqyrtim sqaroj se në bazë të Ligjit nr. 06/L-081 për qasje në dokumente publike, Neni 4 : Parimet themelore të së drejtës në qasje në dokumente publike

1. E drejta për qasje në dokumente publike e secilit person, si dhe garantimi dhe përmbushja e kësaj të drejte nga ana e institucioneve publike përbën një prej themeleve të institucioneve demokratike dhe transparente.

Neni 10:Kërkesa për qasje në dokumente publike

1. Secili person ka të drejtë për qasje në dokumente publike në bazë të kërkesës.
2. Kërkesat për qasje në dokumente publike parashtrohen në çfarëdo mënyre, e cila i mundëson institucionit publik të identifikojë nëse posedon dokumentin publik të kërkuar.
3. Kërkesa mund të bëhet nga personi, me shkrim, në formë elektronike, ose verbalisht. Për aq sa është e mundshme, kërkesa duhet të përmbajë edhe formën e preferuar nga kërkuesi për qasje në dokumente publike.
4. Nëse kërkesa bëhet verbalisht, zyrtari përgjegjës për qasje në dokumente publike obligohet të hartojë kërkesën me shkrim për procedim të mëtejshëm. Nëse kërkesa bëhet në formë elektronike, atëherë ajo konsiderohet si kërkesë me shkrim.

Neni 11: Trajtimi i kërkesave për qasje në dokumente publike

1. Kërkesat për qasje në dokumente publike apo për ripërdorim të dokumenteve publike trajtohen nga cilido institucion publik që posedon dokumentin publik të kërkuar.
2. Zyrtari përgjegjës brenda institucionit publik, me vendim, lejon ose refuzon qasjen në dokumente publike.
5. Institucioni publik ndihmon kërkuesin, aq sa është e mundshme dhe e arsyeshme, të identifikojë dokumentin e kërkuar.
6. Kërkesat për qasje në dokumente publike, apo për ripërdorim të dokumenteve publike trajtohen me shpejtësi dhe sipas parimit të objektivitetit dhe paanshmërisë sipas Ligjit përkatës për Procedurën e përgjithshme administrative.

AK nuk ka vepruar në bazë të Ligjit nr. 06/L-081 për qasje në dokumente publike – Operatorit Ekonomik nuk i ka ofruar qasje në dokumentacionin e kërkuar në bazë të kërkesës së bërë për qasje në dokumentacion më datë: 09.10.2020, si dhe letrës për përkujtim më datë: 19.10.2020. Prandaj bazuar në dëshmitë e lartpërmendura rezultojnë se ky pretendim i OE ankues është i bazuar.

Mendimi i ekspertit shqyrtues: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet e bazuar, ndërsa të anulohet vendimi i AK-së dhe lënda të kthehet në Rivlerësim.

Autoriteti Kontraktues, me datë: 11.11.2020, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Operatori Ekonomik, me datë: 11.11.2020, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues, duke sqaruar:

Pajtohem me mendimin e ekspertit shqyrtues të lëndës tonë lidhur me projektin në fjalë. Ne gjithashtu konsiderojmë se ankesa jonë është plotësisht e bazuar dhe kërkojmë nga Paneli Shqyrtues që të vendosë në favor të ankesës sonë, duke marrë për bazë mendimin e ekspertit shqyrtues:

-Të anulohet vendimi për anulim I AK dhe

-Të kthehet lënda në rivlerësim (ose vlerësim) sepse nuk është vlerësuar dhe AK të vazhdojë procedurën e prokurimit më tutje.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 23.11.2020, pa praninë e palëve konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për anulimin e aktivitetit të prokurimit të kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues të prokurimit dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Në lidhje me pretendimin ankimor nr.1 të parashtruar nga OE ankues "G&A CONSULTING" SH P. K që ka të bëjë kundër anulimit të këtij aktiviteti si dhe Planit Zhvillimor Komunal 2017-2025 i Komunës së Ferizajt për periudhën 8 vjeçare të miratuar sipas Vendimit 01 Nr. 147 dt.: 25.09.2017, Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se njësi kërkuese e AK-së në bazë të Planit Zhvillimor Komunal i cili ka qenë në fuqi me rastin e inicimit të këtij aktiviteti të prokurimit, ka qenë i obliguar që këtë objekt sipas: Nenit 21 të

PZHK ta pajisë me kushte ndërtimore – “Kushtet ndërtimore janë kushtet të cilat shërbejnë si bazë për hartimin e dokumentacionit ndërtimor për çdo parcelë kadastrale ...”

Nëse AK-ja, përkatësisht Njësia kërkuese - Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale kishte bërë kërkesën për marrjen e Kushteve Ndërtimore para fillimit të aktivitetit të prokurimit e që në bazë të PZHU-së është e detyrueshme, Drejtoria e Urbanizmit për dhënien e Kushteve Ndërtimore e kishte njoftuar Njësia Kërkuese se parcela në fjalë është përfshirë në Planin Zhvillimor Komunal 2017-2025, dhe është destinuar për Afarizëm Tregti-Industri dhe nuk mund të pajiset me Kushte Ndërtimore për destinimin e kërkuar. Njësia Kërkuese pas marrjes së kësaj përgjigjeje për parcelën, nuk kishte bërë kërkesë për fillimin e aktivitetit të prokurimit. Mirëpo njësia kërkuese nuk ka vepruar në bazë të PZHU-së dhe ka bërë kërkesën për fillim të aktivitetit të prokurimit, në bazë të së cilës është bërë Njoftimi për Kontratë, si dhe është bërë hapja e ofertave. Ofertat i kanë dorëzuar katër Operatorë Ekonomik të cilët kanë bërë shpenzime për përgatitjen e tyre dhe AK-ja është e obliguar që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit, përkatësisht me vlerësimin, krahasimin dhe ekzaminimin e ofertave. Prandaj, Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues duke u bazuar në dëshmitë e lartpërmendura rezulton se ky pretendim i OE ankues është i bazuar.

Lidhur me pretendimin e OE “G&A CONSULTING” SH P. K se AK-ja nuk na ka ofruar qasje në dokumente edhe përkundrazi kërkesës që kemi dorëzuar tek AK më datë 09.10.2020, Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se në bazë të Ligjit nr. 06/L-081 për qasje në dokumente publike, Neni 4 : Parimet themelore të së drejtës në qasje në dokumente publike

2. E drejta për qasje në dokumente publike e secilit person, si dhe garantimi dhe përmbushja e kësaj të drejte nga ana e institucioneve publike përbën një prej themeleve të institucioneve demokratike dhe transparente.

Neni 10:Kërkesa për qasje në dokumente publike

1. Secili person ka të drejtë për qasje në dokumente publike në bazë të kërkesës.
2. Kërkesat për qasje në dokumente publike parashtrohen në çfarëdo mënyre, e cila i mundëson institucionit publik të identifikojë nëse posedon dokumentin publik të kërkuar.
3. Kërkesa mund të bëhet nga personi, me shkrim, në formë elektronike, ose verbalisht. Për aq sa është e mundshme, kërkesa duhet të përmbajë edhe formën e preferuar nga kërkuesi për qasje në dokumente publike.
4. Nëse kërkesa bëhet verbalisht, zyrtari përgjegjës për qasje në dokumente publike obligohet të hartojë kërkesën me shkrim për procedim të mëtejshëm. Nëse kërkesa bëhet në formë elektronike, atëherë ajo konsiderohet si kërkesë me shkrim.

Neni 11: Trajtimi i kërkesave për qasje në dokumente publike

1. Kërkesat për qasje në dokumente publike apo për ripërdorim të dokumenteve publike trajtohen nga cilido institucion publik që posedon dokumentin publik të kërkuar.

2. Zytari përgjegjës brenda institucionit publik, me vendim, lejon ose refuzon qasjen në dokumente publike.
5. Institucioni publik ndihmon kërkuuesin, aq sa është e mundshme dhe e arsyeshme, të identifikojë dokumentin e kërkuar.

6. Kërkesat për qasje në dokumente publike, apo për ripërdorim të dokumenteve publike trajtohen me shpejtësi dhe sipas parimit të objektivitetit dhe paanshmërisë sipas Ligjit përkatës për Procedurën e përgjithshme administrative.

AK nuk ka vepruar në bazë të Ligjit nr. 06/L-081 për qasje në dokumente publike – Operatorit Ekonomik nuk i ka ofruar qasje në dokumentacionin e kërkuar në bazë të kërkesës së bërë për qasje në dokumentacion më datë: 09.10.2020, si dhe letrës për përkujtim më datë: 19.10.2020. Prandaj bazuar në dëshmitë e lartpërmendura rezulton se ky pretendim i OE ankues është i bazuar.

Paneli Shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe sqarimeve të ekspertit, vjen në përfundim se anulimi i këtij aktiviteti të prokurimit është bërë në kundërshtim me nenin 62 të LPP-së. Andaj, obligohet AK që të bëjë vlerësimin, ekzaminimin dhe krahasimin e tenderëve në harmoni me nenin 59 të LPP-së.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.



Vendimi t'i dorëzohet:

- 1x1 AK Komuna Ferizaj;
- 1x1 OE "G&A Consulting" SH.P.K – Prishtinë;
- 1x1 Arkivës së OSHP-së;
- 1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.